



Në bazë të nenit 22. par. 5.6 të Ligjit nr. 03/l-117 për avokatinë "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 49/2009 dt. 25 mars 2009, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë në seancën e dt. 29.10.2011, bie këtë

T A R I F Ë

për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë tarifë përcaktohen shpërblimet dhe kompensimi i shpenzimeve për punën e avokatëve.

Neni 2.

Kur avokati punën e kryen jashtë vendit, mundet që shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve të e inkasojë sipas tarifës së avokatëve të atij vendi.

Kur avokati kryen punë për subjektin e huaj fizik apo juridik, mundet që shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve t'i kryejë sipas kësaj tarife apo sipas tarifës së avokatëve të vendit prej nga e ka origjinën subjekti për të cilin avokati e kryen punën.

Tarifa e avokatëve të vendit të huaj mund të aplikohet edhe te subjekti fizik apo juridik vendës, nëse atij puna duhet t'i kryhet në vend të huaj.

Tarifën e vendit të huaj avokati mundë të e aplikoj edhe në rast se përfaqësimin e bënë në botën e jashtme në formën e shkruar.

Neni 3.

Nëse avokati për subjekt juridik apo person fizik është i angazhuar për përfaqësim apo mbrotje dhe për kryerje e shërbimeve nga lëmi juridik në mënyrë të përhershme, me palën e tillë mund të lidhë kontratë për përfaqësimin dhe shpërblimin në lartësi mujore paushalle.

Neni 4.

Avokati me klientin e tij mundet që të kontrakojë shpërblimin e tij për punën e tij sipas marrëveshjes së lirë me klientin.

Kontrata e tillë duhet të lidhet në formë të shkruar.

ODA E AVOKATËVE E KOSOVËS

PRISHTINË

Në bazë të nenit 22. par. 5.6 të Ligjit nr. 03/l-117 për avokatinë "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 49/2009 dt. 25 mars 2009, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë në seancën e dt. 29.10.2011, bie këtë

TARIFË

për shpérblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë tarifë përcaktohen shpérblimet dhe kompensimi i shpenzimeve për punën e avokatëve.

Neni 2.

Kur avokati punën e kryen jashtë vendit, mundet që shpérblimin dhe kompensimin e shpenzimeve të e inkasojë sipas tarifës së avokatëve të atij vendi.

Kur avokati kryen punë për subjektin e huaj fizik apo juridik, mundet që shpérblimin dhe kompensimin e shpenzimeve t'i kryejë sipas kësaj tarife apo sipas tarifës së avokatëve të vendit prej nga e ka origjinën subjekti për të cilin avokati e kryen punën.

Tarifa e avokatëve të vendit të huaj mund të aplikohet edhe te subjekti fizik apo juridik vendës, nëse atij puna duhet t'i kryhet në vend të huaj.

Tarifën e vendit të huaj avokati mundë të e aplikoj edhe në rast se përfaqësimin e bënë në botën e jashtme në formën e shkruar.

Neni 3.

Nëse avokati për subjekt juridik apo person fizik është i angazhuar për përfaqësim apo mbrotje dhe për kryerje e shërbimeve nga lëmi juridik në mënyrë të përhershme, me palën e tillë mund të lidhë kontratë për përfaqësimin dhe shpérblimin në lartësi mujore paushalle.

Neni 4.

Avokati me klientin e tij mundet që të kontrakojë shpérblimin e tij për punën e tij sipas marrëveshjes së lirë me klientin.

Kontrata e tillë duhet të lidhet në formë të shkruar.

Kontraten mund ta lidhe perveç klientit secili person i parapare me nenin 69 al.6 te Kodit te Procedures Penale te Kosoves.

II. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 5

Për punën e kryer jashtë selisë së zyrës avokatit, avokatit i takon kompensimi për shpenzime të udhëtimit, kompensimi për shkak të mungesës në zyrë si dhe mëditja.

Avokatit i takon:

- për udhëtim në relacionet ndërurbane, në lartësi të biletës së udhëtimit,
- për udhëtim në relacionet urbane, në lartësi të autotaksive,
- për përdorimin e automjetit personal në lartësi të 30 % të vlerës së benzinës më të shtrenjtë për 1 km. të kaluar,
- për mungesën nga zyra, avokatit i takon kompensimi në lartësi të shumës prej 25 % të kompensimit të paraparë me këtë tarifë.

Mëditja dhe shpenzimet e fjetjes, avokatit i pranohen në lartësi siç parashihet me dispozita ligjore për gjyqtarët e gjykatave të qarkut.

III. PAGESA

Neni 6

Pagesat, në parim bëhen me para të gatshme, pas punës së kryer.

Avokatit, sipas marrëveshjes me palën, mund t'i bëhet pagesa edhe para kryerjes së punës. Avokati ka të drejtë që të kërkoj paradhëdhënje.

Avokati ka të drejtë që shumat e shpenzimeve nga neni parraprak i kësaj tarife t'i inkasojë që më parë.

Me kërkesë të palës, me rastin e pagesave, avokati është i detyruar që t'ia lëshojë dëftesën e shumave të inkasuara.

Neni 7.

Shpërblimi për punën e kryer përcaktohet sipas tarifës në fuqi apo asaj që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer puna. E drejta për të përcaktuar se cila tarifë do të aplikohet, ajo e kohës kur është kryer puna apo kur kryhet pagesa, i takon avokatit.

IV. SHPËRBLIMI PËR PUNËN E AVOKATIT

1. PROCEDURA PENALE

Mbrojtja e të pandehurit/akuzuarit

Numri tarifor 1.

Për mbrojtjen e të pandehurit/akuzuarit, për çdo ditë të asistimit në shqyrtimin gjyqësor, asistimit në procedurën paraprake, procedurën përgatitore te të miturit, asistimi në shiqimin në vendin e ngjarjes, në rikonstruktime, ekspertime dhe në të gjitha veprimet të cilat zbatohen jashtë ndërtesës së policisë, prokurorisë apo gjykatës, avokatit i takon shpërblimi:

- për çështje penale nga kompetenca e gjykatës komunale, shpërblimi në lartësi prej 120 €.
- për çështje penale nga kompetenca e gjykatës së qarkut, shpërblimi në lartësi prej 168 €.

Për proceset e caktuara që nuk mbahen, përkatesisht të shtyra pa fajin e avokatit, avokatit i takon shpërblimi prej 50 % të shumave të lartcitura.

Përfaqësimi i të dëmtuarit, paditësit privat dhe të dëmtuarit si paditës

Numri tarifor 2.

Për përfaqësimin e paditësit privat dhe të dëmtuarit si paditës, avokatit i takon shpërblimi si për mbrojtje, konform nr. tarifor 1.

Për përfaqësimin e të dëmtuarit, avokatit i takon gjysma e shpërbimit të përcaktuar me alinenë paraprake të këtij nr. tarifor.

Përpilimi i parashtresave penale

Numri tarifor 3.

Për përpilimin e kallëzimit penal, padisë penale private, kërkesës për zbatim të hetimeve dhe akuzës të dëmtuarit si paditës, për çështje nga kompetenca e gjykatës komunale, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 96 € (baza), ndërsa për çështje nga kompetenca e gjykatës së qarkut, shpërblimi në lartësi prej 120 €. (baza).

Për përpilimin e të gjitha parashtresave të tjera në procedurën penale, avokatit i takon 50 % i shpërbimit të përcaktuar me alinenë paraprake të këtij numri tarifor.

Mjetet juridike në çështje penale

Numri tarifor 4.

Për çështje në kompetencë të Gjykatës Komunale, avokatit i takon

shpérblimi në lartësi prej 144 € (baza), ndërsa për çështje në kompetencë të gjykatës së qarkut, shpérblimi në lartësi prej 288 €, e për përpilimin, për përpilimin e:

- ankesës së të pandehurit/akuzuarit, paditësit privat dhe të dëmtuarit si paditës kundër aktgjykimit dhe kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar masa e sigurisë apo masa edukuese,
- kërkesës për rishikimin e procedurës penale,
- kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë,
- propozimit për kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë,
- kërkesës për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë.

Avokatit i takon gjysma e shpérblimit e paraparë me alinenë paraprake për përpilimin e:

- prapësimi në akuzë,
- përgjegjës në ankesë,
- ankesës së të dëmtuarit,
- kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit,
- lutjes përfalje të dënimit,
- përgjegjës në propozimin për rishikimin e procedurës penale.

Numri tarifor 5.

Për përpilimin e ankesës kundër aktvendimit për zbatimin e hetimeve, për caktimi apo vazhdimin e paraburgimit apo kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës rishikimin e procedurës, avokatit i takon shpérblimi:

- nëse vepra penale është nga kompetenca e gjykatës komunale, 96 € (baza).
- nëse vepra penale është nga kompetenca e gjykatës së qarkut, 120 € (baza).

1. PROCEDURAT E TJERA

Përpilimi i parashtresave

Numri tarifor 6.

Për përpilimin e parashtresave me të cilat iniciohet zhvillimi i cilës do procedurë para gjykatës apo organit tjeter, avokatit i takon shpérblimi sipas vlerës së çështjes juridike, si:

- për çështje juridike, vlera e të cilave nuk kalon shumën prej 100 €, shuma prej 60 € (baza)
- për çështje juridike vlera e të cilave e kalon shumën prej 100 €, shuma prej 72 € (baza),

Për përpilimin e përgjigjes në padi, prapësimi në aktvendim për lejimin e përmbarimit apo të masës së përkohshme dhe parashtresave të tjera

të arsyetuara të cilat përbëjnë pretendime lidhur me faktet, avokatit i takon shpérblimi si në alinenë 1. të këtij nr. tarifor.

Nëse më shumë kërkesa kumulativisht janë përfshirë në një padi apo propozim, avokatit i takon shpérblimi i plotë për parashtresën e përpiluar dhe rritja për 50 %.

Përfaqësimi në seanca për çështje civile

Numri tarifor 7.

Për përfaqësim në seanca për çështje civile, avokatit i takon:

- për çdo seancë shpérblimi i përcaktuar si për parashtesa, siç është paraparë në numrin tarifor 7. për parashtresat inicuese,
- për çdo seancë të shtyrë, shuma prej 50 % të shpérblimit nga alineja paraprake e këtij numri tarifor.

Shpérblimi si në alinenë 1. të këtij numri tarifor, avokatit i takon edhe për asistim me rastin e ekspertimit, shikimit në vendin e ngjarjes, përkatesisht veprimet procedurale që ndërmerrin jashtë ndërtuesës së Gjykatës.

Përfaqësimet në procedurat e tjera.

Numri tarifor 8.

Në çështjet e kontesteve ekonomike, tregtare, administrative, në çështjet administrativo-fiskale, para bordeve përkatëse aplikohen shpérblimet në lartësitë e përcaktuara me nr. tarifor 8.

Për mbrojtjen e të pandehurit në procedurën disiplinore apo kundërvajtëse, avokatit i takon shpérblimi në shumën prej 60 €. (baza).

Mjetet juridike

Numri tarifor 9

Për përpilimin e mjeteve juridike avokatit i takon shpérblimi i dyfishuar nga shpérblimi i paraparë për parashtresat me të cilat iniciohet procedura (për padi, kërkesë, prapësim etj.).

Përfaqësimi i më shumë palëve

Numri tarifor 10.

Kur avokati përfaqëson dy apo më shumë palë, për përpilimin e të gjitha parashtresave dhe për përfaqësimë në seanca gjyqësore, avokatit i takon shpérblimi i rritur për 50 % për palën e dytë dhe secilën të mëtutjeshme por më së shumti deri në dyfishin e tarifës së paraparë.

1. PËRPILIMI I DOKUMENTEVE

Numri tarifor 11.

Për përpilimin e të gjitha dokumenteve për punët juridike të njëanshme apo të dy apo më shumë anëshme gjatë jetës apo për rastin e vdekjes, kontratave, ujdice, testamentit, legatit, avokati mund të aplikojë shpërblimin e paraparë me numrin tarifor 7. apo që shpërblimin t'a llogarisë në lartësi proporcionale me vlerën e tregut për pasurinë që është lëndë e punës juridike por më së shumti deri 1 % të asaj vlere.

Kur lëndë e çështjes juridike janë dhëniet e përkohshme apo të kohëpaskohshme, si qiraja, renta etj. vlera e tregut përcaktohet me mbledhjen e dhënieve të përkohshme prej 1 – 5 vite.

Për përpilimin e dokumenteve për punët juridike kur vlera nuk është e përcaktuar, avokatit i takon shpërblimi në lartësi të paraparë me numrin tarifor 7. pika 1. e kësaj tarife.

2. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Këshillat me mendimet juridike

Numri tarifor 12.

Për këshillë juridike verbale dhe mendim, avokatit i takon 30 %, ndërsa në rastet më të komplikuara 50 % nga shpërblimi i paraparë me numrin tarifor 1. 2. dhe 8, të kësaj tarife.

Për këshillë apo mendim juridik të shkruar, avokatit i takon shpërblimi i paraparë me numrin tarifor 1. 7. dhe 8.

Asistimi në shqyrtime, seanca e tjera.

Numri tarifor 13.

Për asistim në shqyrtime, seanca, dalje në vend, ekspertime dhe që të gjitha veprimet që organi gjegjës i zbaton në ndërtesën ku organi ka selinë apo jashtë selisë së organit, avokatit i takon shpërblimi për çdo orë të filluar në lartësi prej 30 % nga tarifa bazë, duke llogaritur kohën nga momenti kur fillimi i veprimit në fjalë ka qenë i caktuar.

Avokati ka të drejtë në shpërblimin nga alineja paraprake e këtij numri tarifor edhe nëse asiston në mbledhje të organeve qeverisëse ke personat juridikë apo për takime me persona fizikë dhe juridikë kur diskutohet lidhur me çështje faktike dhe juridike.

Për konsultim me të pandehurin, të akuzuarin apo të gjykuarin, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % nga shpërblimi i përcaktuar me numrin tarifor 1. të kësaj tarife.

Shqyrtimi i shkresave Numri tarifor 14.

Avokatit i takon shpërblimi:

1) për shqyrtimin e shkresave në lartësi prej 50 % të shpërblimit të paraparë me numrin tarifor 1. 7. dhe 8. të kësaj tarife,

2) për shikimin në librat katastrale dhe në librat e tjera publike, për nxjerjen e ekstrakteve nga librat publike, për vërtetimin e plotfuqishmërisë dhe të përmbarushmerisë së vendimeve gjegjëse, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % të përcaktuar me nr. tarifor 1. 7. dhe 8. të kësaj tarife.

Shkresat dhe vërejtjet

Numri tarifor 15.

Për përpilimin e vërejtjeve apo të parashtresave palës kundërshtare në procedurë me të cilat kërkohet përbushja e ndonjë prestimi apo përbajtja nga ndonjë veprim, në çështjet që janë me vlerë, avokatit i takon shpërblimi në lartësi prej 50 % nga shpërblimi nga pikë 1. e numrit tarifor 7. të kësaj tarife.

Vlera paushalle për veprime sporadike

Numri tarifor 16.


Avokati ka të drejtë në inkasimin e shumës paushalle në lartësi prej 30 % nga shuma e përgjithshme e paraparë për veprimin përkatës, për veprimin përkatës, të veprimet e parapara me nr. tarifor 12. kur aplikohet shuma proporcionale në përqindje.

Neni 8.

Kjo tarifë hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, me datë 29.10.2011

Prishtinë, dt. 29.10.2011

Kryetari
E ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Ibrahim Dobruna, d.v.



E K S T R A T

nga Tarifa e avokatëve të Kosovës

Nr. tarifor 1. dhe 2. - Mbrojtja dhe përfaqësimi në çështjet penale:

Mbrojtja dhe përfaqësimi i paditësit privat dhe të dëmtuarit si paditës	Baza	30 % për çdo orë të filluar	30 % paushalli	Gjithsejtë:
në Gjykatën Komunale	120,00 €	36,00 €	46,80 €	202,80 €
në Gjykatën e Qarkut	168,00 €	50,40 €	65,52 €	283,92 €

Për përfaqësim të dëmtuarit në procedurë penale, avokatit i takon 50 % i shpërbimit të lartëcituar.

Nr. tarifor 4. dhe 5. – Përpilimi i parashtresave në procedurën penale:

Lloji i parashtresës	Nga kompetenca e	Baza	30 % paushalli	Gjithsejtë:
Përpilimi i kallëzimit penal, padisë penale private, kërkesës për zbatim të hetimeve, aktakuzës së paditësit si të dëmtuar – paditësit supsidiar.	Gjykatës Komunale	96,0 €	28,80 €	124,80 €
	Gjykatës së Qarkut	120,00 €	36,00 €	156,00 €
Përpilimi i ankesës kundër Aktgjykimit apo Aktvendimit mbi shqiptimin e masës së sigurisë, si dhe të gjitha mjetet e jashtëzakonshme	Gjykatës Komunale	144,00 €	43,20 €	187,20 €
	Gjykatës së Qarkut	288,00 €	86,40 €	374,40 €

Për përpilim të të gjitha parashtresave tjera avokatit i takon 50 % shpërbimit të lartëcituar

Nr. tarifor 6. – Përpilimi i parashtresave në procedurën civile dhe procedurat tjera:

Lloji i parashtresës	Vlera e çështjes	Baza	50 % kl. Përmbar.	30 % paushalli	Gjithsejtë:
Padi – kërkesa	deri 100,00 €	60,00 €		18,00 €	78,00 €
	mbi 100,00 €	72,00 €		21,60 €	93,60 €
Përmbarimi në bazë të titullit përmbarimor	deri 100,00 €	60,00 €	30,00 €	27,00 €	117,00 €
	mbi 100,00 €	72,00 €	21,60 €	28,08 €	121,68 €
Përmbarimi në bazë të dokumentit të besuar	deri 100,00 €	60,00 €		18,00 €	78,00 €
	mbi 100,00 €	72,00 €		21,60 €	93,60 €

Për përpilimin e mjeteve të rregullta apo të jashtzakonëshme juridike shpërbimi tarifor rritet për 100 %.

Nr. tarifor 7. – Përfaqësimi në seancat për çështje civile dhe të tjera:

Lloji i çështjes juridike dhe vlera	baza	30 % ora	30 % paush	Gjithsejtë:
Përfaqësimi në çështje civile, tregtare - ekonomike etj. me vlerë.	deri 100,00 €	60,00 €	18,00 €	101,40 €
	mbi 100,00 €	72,00 €	21,60 €	121,68 €

Për përfaqësim të palës dytë, etj. shpërbimi rritet për nga 50 % për secilën palë, por me së shumti deri 200 % i kësaj tarife, - nr. tarifor 9.

Shpërbimet tjera:

1. Në bazë të nentit 4. të TA avokati me klientin e tij mundet që të kontraktoj shpërbimin për punën e tij sipas marrëveshjes së lirë me klientin, në bazë të kontratës së shkruar.
2. Për veprimet e avokatit në procedurën kundërvajtëse apo disiplinore, shpërbimi i llogaritet analogjikisht si për veprimet me bazë tarifore prej 50 €.
3. Për përpilimin e kontratave, ujdive, testamentit avokatit i takon shpërbimi sipas nr. tarifor 6. apo deri në 1 % të vlerës së tregut të pasurisë që është objekt i punës juridike përkatëse - nr. tar. 11.

Prishtinë,
Date: 29/tetor/2011

Kryetari i OAK
Ibrahim Dobruna

